



PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2012

I DETYRUAR

SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

VARIANTI **A**

Lënda: Letërsi dhe Gjuhë shqipe

Shkollat e mesme: artistike, koreografike, sportive, me kohë të shkurtuar (kurrikula e vjetër)

Udhëzime të përgjithshme:

- Testi përbëhet nga dy pjesë.
- Testi përmban një total prej 50 pikësh.
- Testi ka 25 pyetje. 13 me zgjedhje dhe 12 me zhvillim.
- Për pyetjet me zgjedhje përgjigja e saktë vlerësohet me 1 pikë.
- Për pyetjet me zhvillim përgjigjet konsiderohen orientuese dhe në skemë parashikohen variantet e mundësive të përgjigjeve të nxënësve.
- Vlerësimi i pyetjes *ese* do të bëhet duke pasur parasysh rubrikat në tabelën e vendosur në fund të pyetjes dhe që është posaçërisht për vlerësuesit e testit.
- Saktësia gjuhësore ndikon negativisht në vlerësimin e nxënësit, në ato raste, kur ka përsëritje të theksuar gabimesh ose gabime të cilat prishin në mënyrë të vazhdueshme kuptimin e shprehjes.

PJESA I

Dritëro Agolli

Gri

Pyetja 1	C	1 pikë
Pyetja 2	B	1 pikë
Pyetja 3	D	1 pikë
Pyetja 4	A	1 pikë
Pyetja 5	C	1 pikë
Pyetja 6	B	1 pikë

Pyetja 7 **1 pikë****Motivi:**

- Motivi bazë i kësaj poezie është ai i trishtimit, vetmisë së një njeriu në një realitet në të cilin ai nuk e gjen do veten.

OSE

- Motivi i vetmisë, zhgënjimit.

1 pikë Nëse identifikon motivin e poezisë.

0 pikë Nëse përgjigja e dhënë nuk i përmbahet thelbit të pyetjes ose nuk ka përgjigje.

Pyetja 8 (a) **2 pikë****Mjeti stilistik**

- Ngjyra gri ngrihet deri në nivelin e simbolit.

Gjendja shpirtërore:

- Gjendja shpirtërore që ajo shënon simbolikisht është mërzia, melankolia, që shfaqen si pasojë e zhgënjimit vetmisë dhe mohimit.

1 pikë Nëse zbulon mjetin stilistik.

DHE

1 pikë Nëse shpjegon gjendjen shpirtërore që zbulon simbolika e përdorur.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 8 (b) **2 pikë****Model përgjigjeje*****Përgjigje e plotë***

- Përsëritja monotone e ngjyrës gri, përgjatë gjithë poezisë, hiperbolizon, thekson situatën emocionale të heroit, i cili qëndron pasiv në një mjedis të mbyllur. Gjithashtu ajo thekson një trishtim të pafund e të pashpjegueshëm për shpirtin poetik. Ky trishtim i pafund theksohet edhe nga përdorimi i shumësit qiej dhe ndajfoljes shumë.

Përgjigje e pjesshme

- Përsëritja monotone e ngjyrës gri, përgjatë gjithë poezisë, thekson situatën emocionale të heroit.
- Thekson vetminë.
- Thekson trishtimin.

2 pikë Nëse analizon në mënyrë të plotë se çfarë theksohet nga përsëritja e fjalës *gri*.

OSE

1 pikë Nëse analizon në mënyrë të pjesshme se çfarë theksohet nga përsëritja e fjalës *gri*.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 9 **3 pikë**

- **Figura e intonacionit:** aliteracioni
- **Funksioni:** përgjatë gjithë poezisë përsëriten një grup tingujsh, por veçanërisht shkronjën **i** dhe **g**. Kjo përsëritje krijon rima të brendshme dhe fundore. Ato i japin poezisë një peshë të rënduar emocionale dhe tension gati në të shpërthyer.
- **Ndjenjat që përcillen te lexuesi:** të krijon një ndjesi gërryese, acaruese.

1 pikë Nëse zbulon figurën e intonacionit.

DHE

1 pikë Nëse tregon funksionin që kryen kjo figurë.

DHE

1 pikë Nëse tregon ndjenjat që përjeton si lexues.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 10 **2 pikë**

Ritmi i poezisë:

- Poezia ka një ritëm monoton.

Arsyeja e përdorimit:

- Ritmi monoton është në funksion të përmbajtjes: zymtësia, trishtimi, pesha e rënduar emocionale përputhen natyrshëm me ritmin e ngadalshëm.

1 pikë Nëse përcakton ritmin e poezisë.

DHE

1 pikë Nëse shpjegon arsyen e këtij përdorimi.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 11 (a) 3 pikë**Figurat e stilistikës**

- **Antiteza:** vargu me pjesën tjetër të poezisë.
- **Inversioni:** ikën ... (theksohet që në fillim ikja larg, humbja)
- **Simboli:** lejlekët
- **Retiçenca:** pikat e heshtjes në fund të vargut

Komenti:

- Vargu i fundit hyn në antitezë me pjesën tjetër të poezisë. Lejlekët janë simbole të ëndrrës, të udhëve të përshkuara dikur, të mallit, të ëndrrave dhe horizonteve të hapura. Përdorimi i përsëritur dy herë i këtij vargu dhe antiteza që ai krijon, e thekson edhe më tepër trishtimin, zymtësinë, gjendjen emocionale dhe gati në të shpërthyer të heroit lirik. Vetë vargu përmban edhe nota trishtimi, që shfaqen në tri pikat e heshtjes (retiçencën), që janë në fund të tij. Shumë gjëra mbeten pa thënë, por thjesht nënkuptohen.

3 pikë Nëse komenton vargun e fundit përmes dy figurave të stilistikës.

OSE

2 pikë Nëse komenton vargun e fundit përmes një figure të stilistikës ose përmend dy figura bashkë me ilustrimin përkatës, por pa zbërthimin e tyre.

OSE

1 pikë Nëse komenton vargun e fundit, por nuk përmend asnjë figurë të stilistikës ose përmend një figurë bashkë me ilustrimin përkatës, por pa zbërthimin e tyre.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Shënim:

Nëse përmend vetëm figurat e stilistikës, pa ilustrimin përkatës, nxënësi do të marrë 0 pikë.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 11 (b) 1 pikë**Model përgjigjeje**

- Mungesa e foljes krijon efektin e një palëvizshmërie, gjendjeje statike, mungesë veprimi, ndjeshmërie, të një gjendjeje të mbetur pezull, pa energji, pa forcë, të ngecur diku.

1 pikë Nëse shpjegon efektin që krijohet nga mungesa e foljes.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 12 **2 pikë****Momentet:**

- Pas dritares nuk ka asgjë, një kohë gri, qiell gri dhe një realitet gri (si nëntekst), mjedis pa gjallëri, pa jetë.
- Lajmet që vinë nga realiteti që është jashtë, janë gri (*Gazeta hapet me tituj gri*). Lajme që të mërzhisin, që s'ke interes t'i lexosh.
- Por dhe lajmet personale që i vinë janë të trishtueshme, zhgënjyese dhe që ndoshta i shkaktojnë vetmi.

2 pikë Nëse identifikon dy momente, ku realiteti e përforcon gjendjen në të cilën ndodhet heroi lirik.

OSE

1 pikë Nëse identifikon vetëm një moment.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

PJESA II**Balzak*****Evgjeni Grande***

Pyetja 13	C	1 pikë
Pyetja 14	B	1 pikë
Pyetja 15	C	1 pikë
Pyetja 16	D	1 pikë
Pyetja 17	B	1 pikë
Pyetja 18	A	1 pikë
Pyetja 19	D	1 pikë

Pyetja 20 (a) **2 pikë****Model përgjigjeje**

- Ajo mendon kështu, pasi Grandeja po tregohet i dashur, i përkushtuar, në kundërshtim me sjelljen e tij të zakonshme.

Ilustrimi

- *ai e kapte përkrahu*
- *ia mbërthente sytë ëmbël-ëmbël*
- *e ruante sikur të ish prej floriri.*

1 pikë Nëse tregon pse Evgjenia mendon se i ati ka ndryshuar.

DHE

1 pikë Nëse mendimin e mbështet me një ilustrim nga fragmenti (të perifrazuar ose të marrë drejtpërdrejtë).

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 20 (b) 1 pikë**Model përgjigjeje**

- Grandeja do që t'i marrë mendjen së bijës, me qëllim që ajo ta kalojë pasurinë që zotëron nga e ëma në emër të tij.

1 pikë Nëse tregon arsyen e vërtetë të sjelljes së Grandesë.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 21 2 pikë**Model përgjigjeje****Përgjigje e plotë**

- Marrëdhënia midis atit dhe bijës nuk është si pritet të jetë në një rast të tillë. Ndjenjat e Evgjenisë janë si ato të një bije ndaj të atit, kurse Grandeja nuk ushqen ndjenja të tilla. Dashuria e tij e vetme janë paratë dhe ai kujdeset vetëm për to. Pra raporti i dashurisë dhe respektit midis atit dhe bijës është vetëm i njëanshëm. Atë e tregon vetëm Evgjenia.

Përgjigje e pjesshme (Shpjegon vetëm një pjesë të raportit)

- Grandeja nuk e do të bijën
- Vetëm Evgjenia tregon dashuri dhe përkujdesje

2 pikë Nëse jep një përgjigje të plotë, ku zbulon thelbin e këtij raporti..

OSE

1 pikë Nëse jep një përgjigje të pjesshme, ku zbulon pjesërisht thelbin e këtij raporti.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 22 2 pikë**Shprehjet frazeologjike**

- *e nxori sheshit fytyrën – u shfaq, u zbulua;*
- *t'ia thyesh zemrën tyt eti - ta mërzisësh, ta plagosësh;*
- *mbeteni fare me gisht në gojë - mbetet trokë, pa asgjë;*
- *ia zuri në gojë – ia përmendi;*
- *sa para bën për mua – s'ka rëndësi, s'ka vlerë.*

1 pikë Nëse identifikon një shprehje frazeologjike.

DHE

1 pikë Nëse gjen sinonimin e saj

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 23 (a) 2 pikë**Model përgjigjeje**

- Evgjenia nuk e njih paranë, nuk i intereson ajo, s'ka asnjë vlerë për të.

Ilustrimi:

- *unë s'po marr vesh asgjë nga këto që më thoni;*
- *më tregoni vendin se ku duhet të vë firmën;*
- *unë bëj ç'të duash ti, o im atë!*
- *Sa para bën për mua?*

1 pikë Nëse tregon raportin që Evgjenia ka me paranë.

DHE

1 pikë Nëse e mbështet mendimin me një shembull nga fragmenti.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 23 (b) 2 pikë**Toni**

- I vendosur, autoritar, serioz.
- Përdorimi i këtij lloj toni na lë të kuptojmë sa autoritar është Grandeja. Ai nuk lë asnjë vend për diskutime dhe fjala e tij nuk mund të kundërshtohet. Ai kërkon bindje të plotë nga Evgjenia. Me këtë ton ai i imponohet asaj.

1 pikë Nëse tregon natyrën e tonit të përdorur nga Grandeje.

DHE

1 pikë Nëse shpjegon se ç'tregon ky ton në lidhje me natyrën e plakut.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 24 2 pikë**Ndjesia është personale:**

- mund të ndiejnë simpati për Evgjeninë, keqardhje.
- mund të ndiejnë: habi, zemërim, trishtim (si mund të jetë një njeri kështu), përçmim, neveri, etj.

1 pikë Nëse tregon ndjesinë që provon për Evgjeninë.

DHE

1 pikë Nëse tregon ndjesinë që provon për plakun Grande.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 25 **8 pikë**

Për esenë do të ndiqen kriteret e mëposhtme:

KRITERI I: SHTJELLIMI I IDESË **2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- shkruan një ese, ku argumenton se si sjelljet dhe pasojat ekstreme ndikojnë në jetën e Grandesë, por edhe të njerëzve që jetojnë me të;
- mban qartë një pozicion të dukshëm, por bazuar në pjesën e dhënë;
- përdor detaje mbështetëse, duke iu referuar përvojës personale ose edhe përvojave të të tjerëve;
- ka qartësi mendimi.

KRITERI II: ORGANIZIMI DHE STRUKTURA E ESESË **2 pikë****1 pikë** **Struktura e esesë**

- respekton elementet e strukturës së esesë:
 - hyrjen
 - zhvillimin
 - përfundimin

Nxënësi merr **1 pikë** nëse përgjigjen e dhënë e strukturon sipas skemës së mësipërme.

1 pikë **Organizimi i esesë**

- organizim logjik, ku shfrytëzohen teknika të tilla si koherenca dhe unifikimi i paragrafëve (lidhja logjike mes paragrafëve, kalimi në mënyrë të natyrshme).

KRITERI III: STILI DHE ORIGJINALITETI **2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- përmes gjuhës që përdor, krijon një përshtypje të përgjithshme për atë që do të shprehë.
- shprehet me një gjuhë eseistike.
- ka fjalor të pasur.
- stil origjinal.

KRITERI IV: SAKTËSIA GJUHËSORE **2 pikë****(1 pikë sintaksa dhe 1 pikë drejtshkrimi)**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- strukturon qartë përgjigjen nga pikëpamja gramatikore.
- ndërton fjali që janë të sakta dhe të qarta.
- përdor fjali që variojnë në modele, gjatësi dhe ritëm.
- ka saktësi drejtshkrimore.